




Albert Bushkany
A



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

R. Nogaj

Nr. 1718 / Prot.
10

Vlorë më, 21.11.2024

VENDIM

Nr. 80, datë 20.11.2024

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË
"INFERMIERI E PËRGJITHSHME", NË FAKULTETIN E SHËNDETIT, PËR
VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja dh, nenit 73, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Departamentit të Infermierisë, si dhe propozimit të Zëvendësrektorit Akademik, përcjellë me shkresën 2651, prot, datë, 19.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.11.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Infermierisë, në Fakultetin e Shëndetit për riorganizimin e programit të studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit Akademik, Drejtuesit e Fakultetit të Shëndetit, si dhe Drejtoria e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj





UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ZV/REKTORI AKADEMIK

Nr. 26.51. Prot

Vlorë, më 19. 11. 2024

Lëndat: Përcillen për miratim në Senatin Akademik propozimet e fakulteteve për hapjen e programeve të reja të studimit, për vitin akademik 2025-2026".

PROF.DR.AURELA SALIAJ
KRYETARE E SENATIT AKADEMIK

KËTU:

Bezuar në Udhëzimin e MAS me Nr. 1, datë 14.01.2020 "Mbi dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit si dhe bashkimin ose ndarjen e IAL-ve", në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, (i ndryshuar) "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" si dhe në Relacionin e Drejtorisë së Edukimit për Ciklin I dhe II të studimeve, përçjellim për miratim në Senatin Akademik, propozimet e fakulteteve për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit për Vitin akademik 2025-2026 si më poshtë:

I. Fakulteti i Shëndetit

(Departamenti i Kujdesit Shendetesor)

1. Bachelor në " Teknik Laboratori "- Hapje program i ri
2. Bachelor në "Infermieri e Pergjitheshme"-Riorganizim

II. Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore

(Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjise)


1. Bachelor në "Inxhinieri Elektrike: (Diplome dyfishe)- Riorganizim

Bashkëlidhur kësaj shkrese:

1. Relacioni i Drejtorisë së Edukimit për Ciklin I dhe II të studimeve.
2. Aplikimet e fakulteteve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

ZV/REKTORI AKADEMIK
PROF.AS.MAJLINDA ZAHAJ



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E EDUKIMIT PER CIKLIN I DHE II TE STUDIMEVE

Vlore, me 19.11.2024

**RELACION MBI RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TE
STUDIMIT**

BACHELOR NE" INXHINIERI ELEKTRIKE"

Në zbatim të udhëzimit të MAS me Nr. 1, datë 14.01.2020 "Mbi dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe bashkimin ose ndarjen e IAL-ve", nga ana e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjise, me shkresën Nr.2614 dt 18.11.2024, është paraqitur propozimi për riorganizimin e programit të të studimit: *Bachelor ne" inxhinieri elektrike" në*

Bachelor në" Inxhinieri Elektrike"(Diplomë dyfishe)

në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit.

Nëpërmjet këtij projekt propozimi synohet të riorganizohet programi bazë në Inxhinieri Elektrike i ofruar nga Universiteti i Vlorës Ismail Qemali, në një program studimi i cili u mundëson studentëve që ndjekin këtë program studimi dhe që në përfundim të vitit të parë të studimeve në UV do të kenë mundur të plotësojnë standartet akademike të parashikuar në marrëveshjen specifike të lidhur midis Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" dhe Universitetit Politeknik të Barit, të vazhdojnë studimet për 2 vitet vijuese akademike pranë Universitetit Politeknik të Barit. Gjithashtu projekt propozimi u mundëson studenteve të cilët ndjekin studimet në Programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike pranë Universitetit Politeknik të Barit dhe që në përfundim të semestrit të katërt (viti i dytë) do kenë mundur të plotësojnë standartet akademike të parashikuar në marrëveshjen specifike të lidhur midis Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" dhe Universitetit Politeknik të Barit, të vazhdojnë studimet për vitin e tretë (semestri i pestë dhe i gjashtë) pranë Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali".

Riorganizimi i studimeve në këtë program studimi të ciklit të parë (Bachelor), organizuar me 180 kredite, me një kohëzgjatje prej 6 semestrash (3 vite akademike) në thelb ruan boshtin e programeve bachelor në Inxhinieri Elektrike të cilat ofrohen aktualisht nga të dyja IAL-të (UV dhe POLIBA). Referuar marrëveshjes specifike (Marrëveshje dypaleshe Nr. 1296 prot, date 31.05.2024) të nënshkruara nga UV dhe PoliBa, studentët e Universitetit të Vlorës, të cilët



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E EDUKIMIT PER CIKLIN I DHE II TE STUDIMEVE

plotësojnë kriteret në përfundim të vitit të parë të studimeve pranë UV-së do të kenë mundësinë të vazhdojnë dy vitet e tjera të studimeve pranë Universitetit Politeknik të Barit. Kurse studentët e Universitetit Politeknik të Barit, të cilët plotësojnë kriteret në përfundim të vitit të dytë të studimeve pranë POLIBADO të kenë mundësinë të vazhdojnë vitin e tretë të studimeve pranë Universitetit të Vlorës. Studentët e të dyja IAL-ve do të përgatisin tezën e diplomës Bachelor pranë Universitetit pritës.

Vizioni i Programit të studimit

Nëpërmjet këtij programi studimi synohet të vihet në zbatim vizioni i Universitetit të Vlorës për diplomimin e studentëve në fushën e Inxhinierisë Elektrike duke siguruar edukim ekselent në këtë fushë me synim formimin e specialistëve të lartë të fushës së inxhinierisë Elektrike me njohuri të avancuara në funksion të zhvillimeve rajonale.

❖ Misioni i programit të studimit.

Programi i riorganizuar (duke përfshirë edhe diplomën e dyfishtë në Inxhinieri Elektrike me PoliBa) synon të ofroj një arsimit në fushën e inxhinierisë Elektrike të cilësisë së lartë për të gjithë studentët e Rajonit të Jugut të Shqipërisë dhe me gjerë. Programi ka si synim tu ofroj studentëve një sërë aftësish dhe njohurish që do ti mundësojnë të diplomuarve të kenë një karriere të suksesshme qoftë në aspektin inxhinierik qoftë në aspektin e lidërshiptit.


❖ Objektivat formues të programit të studimit

Objektivat formues të programit të riorganizuar të studimeve duke përfshirë edhe diplomën e dyfishtë Bachelor në Inxhinieri Elektrike me Universitetin Politeknik të Barit synojnë formimin e inxhinierëve elektrike në gjendje që të përballojë probleme tipike të projektimit në sektorin elektrik si dhe të kuptojë dhe drejtojë inovacionet në të gjitha disiplinat e sektorit elektrik, duke përfshirë fitimin e njohurive të mjaftueshme për të mbuluar veprimtaritë në njësitë e mëposhtme të :

- Prodhimit të energjisë elektrike në impiantet elektrike;
- Transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike;
- Përdorimit të energjisë elektrike në impiantet industriale, në sistemin urban dhe rural;
- Menaxhimin e energjisë elektrike në tregun e energjisë elektrike;
- Instalimeve elektrike dhe mirëmbajtja e tyre në banesa, objekte të ndryshme private dhe publike etj.

Ky program studimi e aftëson studentin për të vazhduar studimet në programet e studimit të ciklit të dytë.

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike ofron larmirshmëri opsionesh punësimi të të diplomuarve nga ky program studimi. Inxhinierët elektrik mund të punësohen në



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E EDUKIMIT PER CIKLIN I DHE II TE STUDIMEVE

pozicione të ndryshme teknike dhe drejtuese. Sektorët kryesorë të punësimit të inxhinierëve elektrik janë:

- Sistemet e prodhimit të energjisë elektrike;
- Sistemet e transmetimit të energjisë elektrike;
- Sistemet e shpërndarjes dhe përdorimit të energjisë elektrike;
- Në kompani për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektro energjetike me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët.
- Në shoqëri për shitblerjen e energjisë elektrike;
- Në impiante për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.
- Të vetëpunësuar.

- + Lloji i programit: Bachelor (Diplome dyfishe)
- + Kohezgjatja: 3 vite, 6 semestra
- + Kreditet: 180 kredite.
- + Njesia ofruese : Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjise
- + Staf i akademik: Gjithsej 12 pedagogë të UV .
- + Nga pedagogët ,6 janë të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjise, 3 nga Dep Matematikes dhe fizikes dhe 1 nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike,1 Dep i kimise dhe 1 Dep i gjuheve te huaja
- + Viti akademik :2025-2026

Analiza e Planit mesimor:

Struktura e planit mesimor	Struktura sipas VKM 41 dt 24.01.2018 (i ndryshuar)
Lende baze : 36 kredite (20%)	15-20%
Lende karakterizuese: 96 kredite (53.3%)	50-55%
Lende nderdisiplinore/integruese -24 kredite (13.3%)	12-15%
Lende plotesuese:18 kredite (10%)	10-15%
Detyrime permbyllese :6 kredite (3.4%)	3-5%

Bashkëlidhur Formatit i aplikimit .

DREJTORI
Alberta Breshanaj

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al